



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale Nr.. 03/L-040, Ligjit për financat e pushtetit lokal Nr..03/L-049, si dhe nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 569/1 të dt.16.12.2010, dhe rekomandimit të komisionit të përbashkët MEF-MAPL dhe MMPH, për vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale, 01. Nr .3007 e dt. 27. 09. 2016. Kuvendi i Komunës Komunës së Rahovecit aprovoi këtë:

R R E G U L L O R E PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE

Neni 21

DREJTORIA PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM DHE TURIZËM:

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Komuna cakton lartësinë e tarifës dhe ngarkesave për çdo subjekt afarist që merret me ushtrimin e veprimtarisë ekonomike brenda kufijve të komunës. Përcaktimet e detyrimeve bëhen vetëm pasi subjekti afarist paraqet dëshmi të mjaftueshme si provë për regjistrimin e subjektit në institucionet e autorizuar. Lartësia e përcaktimit të tarifave, ngarkesave dhe gjobave përcaktohet sipas rregullores së miratuar nga Kuvendi i Komunës.

Përcaktimi i tarifave për taksa, ngarkesa dhe gjoba është bërë në bazë të klasifikimit dhe veprimtarive afariste të bizneseve si në vijim:

Taksat dhe ngarkesat vjetore për ushtrimin e afarizmit për subjekte juridike (ndërmarrjet)

Nr	Emertimi	Vlera
1	Aktvendimi mbi ndërrimin e pronarit, emrit të firmës [lokali i njëjtë]	20,00 €
2	Aktvendimi për vazhdimin e orarit në hotel, restorant dhe motel për një natë	30,00 €
2a	Aktvendim për leje pune në ditët e festave për 1/ditë	20.00 €
2b	Leje të posaqme ndërmarrjeve ndërtimore /në rastet jashtëzakonshme për shkak natyres së punëve (deri në ora 23h) 1/ditë	20.00 €
bc	Të gjitha veprimtaritë për orare të zgjatur të çfarëdo veprimtarie për 1/ ditë	20.00 €
2d	Aktvendim për leje pune në ditët e festave për 1/vit	100.00 €

3	Aktvendimi për vazhdimin e orarit të punës në hotel, restorant dhe motele për një muaj, vetëm për dasma dhe ahengje	600,00 €
3a	Leja e punës për Ekonomi Familjare	1,00 €
3b	Dhënia e pelqimit për shitjen e produkteve –Artizanale, punëdore dhe për Ekonomit Familjare	1,00 €
3c	Leja e punës për artizanate-Ekonomi Familjare	1,00 €
3d	Dhënia e Vërtetimit,dëshmi për Kontributin e sigurimit penzional,Invalidor,për bizneset e regjistruara para Luftes.	1,00 €

Neni 21.1

ÇMIMI FILLESTAR I DHËNIES SË PRONËS KOMUNALE (ANKAND PUBLIK)

TAKSË MUJORE

Nr	Emertimi	Vlera
1	Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim (me qira) te lokaleve ekonomiko afariste (Qytet) (ÇMIMI FILLESTAR)	2.00 €/m2 Mujore
2	Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim (me qira) te Depove (Matrexi) (Xerxe) (ÇMIMI FILLESTAR)	0.50 €/m2/Mujore
3	Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim (me qira) te Tregjeve (Qytet) (ÇMIMI FILLESTAR)	0.20 €/m2 /Mujore
4	Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim (me qira) te Tregjeve (Fshat) (ÇMIMI FILLESTAR)	0.10 €/m2 /Mujore

Çmimet fillestare për dhënie në shfrytëzim të tokës komunale

(Me ankand publik), taksa mujore.

Neni-22

22.1 Qiraja për shfrytëzimin e tokës komunale nëpër vendbanime dhe vise tjera rurale të Komunës së Rahovecit është si në vijim:

- a) çmimi i qirasë mujore për zonën e parë që përfshin pronat komunale që shtrihen përgjatë rrugëve magjistrale është 0.15 euro për 1m²,
- b) çmimi i qirasë mujore për zonën e dytë që përfshin pronat komunale në periferi të rrugëve magjistrale është 0.10 euro për 1m²,
- c) çmimi i qirasë mujore për zonën e tretë që përfshin pronat komunale kodrinore-malore është 0.02 euro për 1m² dhe
- d) Nëse toka komunale shfrytëzohet për vendosjen e objekteve të përkohshme në sipërfaqe deri në 15m², qiraja mujore për tokë do të jetë 30 euro, kurse mbi 15 m² për çdo m² paguhet nga 1 euro.

22.2 Qiraja për shfrytëzimin e tokës komunale me qëllim të vendosjes apo ndërtimit të objekteve për veprimtari të caktuar është si në vijim:

- a) çmimi i qirasë mujore për zonën e parë është,.....0.50/ euro për 1m²;
- b) çmimi i qirasë mujore për zonën e dytë është,..... 0.30/ euro për 1m²;
- c) çmimi i qirasë mujore për zonën e tretë është,..... 0.20/ euro për 1m².

22.3 Qiraja duhet paguar në baza mujore dhe pagesa duhet të kryhet në bazë të Kontratës.

Neni 23

Tabela sipas Sektorëve dhe Kodeve të ARBK-së

Nr	Kodi	SEKTORI	Vlera
B - MINIERAT DHE GURORET (INDUSTRIA NXJERRËSE)			
B 1	811	Nxjerrja e gurit dekorativ dhe të ndërtimit, gurit gëlqeror, gjipsit, shkumësit dhe rrasave	500.00 €
B 2	812	Nxjerrja e zhavorrit dhe rërës, nxjerrja e argjilës dhe kaolinit	500.00 €
C - INDUSTRIA PËRPUNUESE			
C 1	1061	Përpunimi i produkteve të drithërave	200.00 €
C 2	1102	Prodhimi i verës nga rrushi	500.00 €
C 3	1729	Prodhimi i artikujve të tjerë prej letrës dhe kartonit p.k.t.	200.00 €
C 4	1813	Shërbimet e përgatitjeve para-shtypjes dhe para-publikimit	50.00 €
C 5	2363	Prodhimi i betonit të përzier, i gatshëm për përdorim	500.00 €
E - FURNIZIMI ME RRYMË, GAZ, AVULL DHE AJËR TË KONDICIONUAR			

E 1	3513	Shpërndarja e energjisë elektrike	2,000.00 €
E 2	3600	Grumbullimin, trajtimin dhe furnizimin me ujë	300.00 €
E 3	3700	Kanalizim	150.00 €

F - NDËRTIMTARIA

F 1	4120	Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore	150.00 €
F 2	4331	Punime suvatimi	100.00 €

G - TREGTIA ME SHUMICË DHE PAKICË

G 1	4511	Tregtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike të vogël	100.00 €
G 2	4520	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	100.00 €
G 3	4661	Tregtia me shumicë e makinerive bujqësore, pajisjeve dhe pjesëve furnizuese	200.00 €
G 4	4671	Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhur me to	300.00 €
G 5	4673	Tregtia me shumicë e drurit, materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve hidrosanitare	200.00 €
G 6	4674	Tregtia me shumicë e pjesëve elektronike, pajisjeve hidraulike dhe të ngrohjes, si dhe pjesëve të furnizimit	100.00 €
G 7	4675	Tregtia me shumicë e produkteve kimike	100.00 €
G 8	4677	Tregtia me shumicë e mbeturinave dhe hekurishteve	100.00 €
G 9	4711	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani	50,00 €
G 10	4721	Tregtia me pakicë e frutave dhe perimeve në dyqane të specializuara	50,00 €
G 11	4722	Tregtia me pakicë e mishit dhe produkteve të mishit në dyqane të specializuara	150,00 €
G 12	4724	Tregtia me pakicë e bukës, ëmbëlsirave, produkteve prej mielli dhe produkteve prej sheqeri, në dyqane të specializuara	100,00 €
G 13	4730	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete në dyqane të specializuara	250.00 €
G 14	4741	Tregtia me pakicë e kompjuterëve, njësive periferike dhe softuerëve, në dyqane të specializuara	100.00 €
G 15	4751	Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara	50.00 €
G 16	4754	Tregtia me pakicë e pajisjeve elektroshtëpiake në dyqane të specializuara	200,00 €
G 17	4759	Tregtia me pakicë e mobilieve, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve të tjerë shtëpiake, në dyqane të specializuara	300.00 €
G 18	4771	Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara	100,00 €
G 19	4773	Tregtia me pakicë e artikujve farmaceutikë në dyqane të specializuara (Barnatore)	150.00 €
G 20	4775	Tregtia me pakicë e artikujve kozmetikë dhe të tualetit, në dyqane të specializuara	50,00 €

H - TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI

H 1	4939	Ndërmarrjet për transport të udhëtarëve	50.00 €
H 2	4941	Ndërmarrjet për transport të mallrave	50.00 €

I - AKOMODIMI DHE SHËRBIMI USHQIMOR

I 1	5510	Hotelet dhe akomodimi i ngjashëm	200.00 €
I 2	5590	Akomodimet tjera	300.00 €
I 3	5621	Furnizimi me ushqim me porosi për raste	300.00 €

I 4	5610	Restorantet dhe aktivitetet shërbyese lëvizëse të ushqimit	150.00 €
J - INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI			
J 1	5310	Aktivitetet e postave me detyrimin e shërbimit të përgjithshëm	300.00 €
J 2	5911	Aktivitetet e prodhimit të filmave, videove dhe programeve televizive	10.00 €
J 3	5920	Incizimi i zërit dhe aktivitetet e publikimit të muzikës	10.00 €
J 4	6020	Aktivitetet e transmetimit të programeve televizive	200.00 €
J 5	6110	Aktivitetet e telekomunikimit kabllor	1,000.00 €
K - AKTIVITETET FINANCIARE DHE TË SIGURIMIT			
K 1	5229	Aktivitetet e tjera mbështetëse të transportit	100.00 €
K 2	6419	Ndërmjetësimet e tjera monetare	1,000.00 €
K 3	6492	Aktivitetet e tjera të kredisë	500.00 €
K 4	6499	Aktivitetet e tjera shërbyese financiare, përveç fondit të sigurimit dhe atij pensional p.k.t.	1,000.00 €
K 5	6512	Sigurimet jetsore	500.00 €
M - AKTIVITETET PROFESIONALE, SHKENCORE DHE TEKNIKE			
M 1	6910	Aktivitetet juridike	100.00 €
M 2	7112	Aktivitetet e inxhinierisë dhe këshillimit teknik	100.00 €
M 3	7120	Testimi Teknik dhe analizat	500.00 €
M 4	7430	Aktivitetet e përkthimit dhe interpretimit	100.00 €
M 5	7500	Aktivitetet e veterinaris	50.00 €
P - ARSIMI			
P 1	8553	Aktivitetet e Autoshkollave	100.00 €
Q - AKTIVITETET E SHËNDETIT TË NJERIUT DHE TË PUNËS SOCIALE			
Q 1	8610	Aktivitetet e spitaleve	200.00 €
Q 2	8623	Aktivitetet e dentistëve	150.00 €
Q 3	8690	Aktivitetet e tjera të shëndetit të njeriut	100.00 €
R - ARTET, ARGËTIMI DHE REKREACIONI			
R 1	9200	Aktivitetet e lojërave të fatit dhe basteve	1000,00€
S- AKTIVITETET E TJERA SHËRBYESE			
S 1	9604	Aktivitetet e mirëmbajtjes trupore	50.00 €